PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Subjekti: ALMARINA OR Sh.p.k

Aktiviteti: LINJE PAKETIMI DHE MAGAZINIMI I PESHQEVE

Përfaqësuesi Ligjor
Shoqeria "ALMARINA OR"
Z. SHEME KONDI

AKTIVITETI: Trajtim dhe magazinim i peshqve
Vendndodhja Objekt 5 Katesh, kati i pare, Zona Kadastrale 2832, Orikum, Vlore.
Subjekti: "**ALMARINA OR"**

Administrator: Z. Sheme KONDI

<table>
<tr><td>Emri i instalimit/impiantit[1]</td><td>Linje Paketimi dhe Magazinim i peshqve</td></tr>
<tr><td>Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti</td><td>Rruga Kaonet, Objekt 5 Katesh, kati i pare, Zona Kadastrale 2832, Orikum, Vlore.</td></tr>
<tr><td>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE:1942_GK_ZONE_4
 </td><td>
<table>
<tr><th colspan="3">Kordinatat e Magazines se Peshkut</th></tr>
<tr><th>Pikat</th><th>X</th><th>Y</th></tr>
<tr><td>1</td><td>44 67 533</td><td>43 70 437</td></tr>
<tr><td>2</td><td>44 67 534</td><td>43 70 447</td></tr>
<tr><td>3</td><td>44 67 540</td><td>43 70 451</td></tr>
<tr><td>4</td><td>44 67 535</td><td>43 70 457</td></tr>
<tr><td>5</td><td>44 67 536</td><td>43 70 466</td></tr>
<tr><td>6</td><td>44 67 520</td><td>43 70 485</td></tr>
<tr><td>7</td><td>44 67 497</td><td>43 70 483</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi [2]</td><td>"Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to,

ID 7.7 f, Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve",</td></tr>
<tr><td>Kapaciteti i projektuar</td><td>Te gjitha instalime

Kapaciteti magazinues është 20 ton peshk në ditë (në varësi të kërkesave dhe mundësisë për produktet e peshkut)

Siperfaqe ku zhvillohet aktiviteti eshte 694.71m^2</td></tr>
</table>

[1] Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

[2] Shkruani kodet e specifikuara në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuara në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

Profili i subjektit "ALMARINA OR" per aktivitetin Trajtim dhe magazinim i peshqve

Instalimi Trajtim dhe magazinim i peshqve të subjektit **"ALMARINA OR"** është i pozicionuar ne katin e pare te objektit 5 katesh, Rruga Kaonet, zona kadastrale 2832, Orikum, Vlore. Ky subjeki është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për aktivitetin Rritjen dhe tregtimin e peshkut te ujerave te kripur, te embel dhe te kafsheve ne pergjithesi, drejtimin e fermave bujqesore mbi fonde ne pronesi, qira, shoqeri bujqesore dhe koncesione,kerkim dhe eksperimentim te teknologjive te reja te mbareshtrimit, furnizim sherbimesh te lidhura dhe gjithashtu konsulence teknike ne sektorin e akuakultures. Aktivitete te trasformimit, konservimit dhe tregrimit te produkteve te peshkut dhe te produkteve ushqimore ne pergjithesi, si te tijat ashtu dhe te te treteve. Tregtia mund te behet edhe me shumice, me pakice ose nepermjet kanaleve telematike. Aktiviteti i trasportit te mallrave per llogari te te treteve, me mjete te sajat ose te te treteve me interes te veçante ne territorin shqiptar dhe ne gjithe hapesiren ballkanike. Aktiviteti i prodhimit dhe tregrimit te ushqimit, edhe jashte territorit te shtetit. Aktiviteti i prodhimit te energjise elektrike dhe te çdo lloj tipologjie energjie alternative. Shoqeria mund te zhvilloje gjithashtu aktivitetet: Blerjes, shitjes dhe administrimit ne shoqeri kapitalesh dhe personash, edhe jo rezidente ne territorin e shtetit. Mund te leshoje dorezani dhe garanci reale, aktiviteti financiar duhet te zhvillohet ne zbatim te ligjeve te fushes. Blerjen dhe shitjen e terreneve per ndertim dhe bujqesor, administrim i planeve te ndertimit, punime ndertimi si vete ashtu dhe ndaj te treteve ne sipermarrje, sipermarrje publike dhe private ne pergjithesi. Ndertimi i banesave, industriale, artizanale, tregtare dhe bujqesore, si per llogari te saj ashtu dhe per
llogari te te treteve. Ndertimi dhe/ose administrimi i aktiviteteve te pritjes ne pergjithesi edhe me shitjen e pijeve dhe ushqimeve. Shoqeria, mund te kryeje te gjitha veprimet tregtare, industriale, te pasurive te paluajtshme dhe financiare per te cilat, ne varesi te formes se shoqerise nuk ka pengese ligjore dhe ne lidhje me objektin e shoqerise, mund te marre kredi nga instimte kredie, banka, private ose ente publike, duke dhene te gjitha garancite hipotekore, mund te leshoje dorezani dhe te detyrohet per te tjere, edhe si i trete dhenes i hipotekes me NR NIUS: **L56506204C**. Objekti ku ushtrohet aktiviteti per trajtimin dhe magazinim e peshqve dhe produkteve te tij eshte ekzistues, ne pronesi te shoqerise MEHILLAJ, ky objekt i ploteson te gjitha kushtet per zhvillimin dhe operimin e instalimeve per trajtimin dhe magazinim e peshqve dhe produkteve te detit, i dimensionuar dhe projektuar qe ne faze te hershme per procese te tilla pune, pasqyruar dhe ne Lejen e Ndertimit ku kati i pare eshte njesi sherbimi.

Objekti disponon hapsira te mjaftueshme per zhvillimin e te gjitha proceseve teknologjike per trajtimin dhe magazinimin e peshqve dhe produkteve te detit, duke i ndare ato ne sektore te vecante, sipas natyres se punes.
Sierfaqja ku zhvillohet aktiviteti eshte 694.71 m^2.

Informacion mbi subjektin "ALMARINA OR"

Subjekti **"ALMARINA OR"** zhvillon aktivitetin e tij ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e Konservimit, Tregtim me pakice dhe shumice te peshkut dhe produkteve te tjera te detit. Transport per nevojat e veta. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise se produkteve te peshkut dhe detit, si dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti **"ALMARINA OR"** referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre

lejeve nga QKB-ja" ka plotesuar Formularit e Kerkeses per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B per aktivitetin Trajtim dhe magazinim i peshqve dhe produkteve te detit, me vendndodhje Kati 1, objekt 5 katesh, zona kadastrale 2832, Orikum, Vlore. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është trajtimi, konservimi dhe magazinimi i perkohshem, tregtimin me shumice dhe pakice i peshqve dhe produkteve te detit, duke furnizuar me produkte cilesore tregun vendas.

- **Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Subjekti **"ALMARINA OR"** si firmë me aktivitet në fushën e trajtimit, konservimit dhe magazinimin e perkohshem, tregtimit te peshqve dhe produkteve te detit, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore.

Sipas natyres se operacioneve qe realizojne teknologjia dhe instalimet e perdorura jane:

- Reparti i trajtimit te peshkut dhe i produkteve te detit
- Siperfaqe magazinuese
- Dhoma frigoriferike ftohese dhe freskuese
- Sektori i larjes se peshkut dhe i produkteve te tij
- Dhomat e zhveshjes se punonjesve, banjot etj
- Zyra

Strukturat specifike per paketimin e peshkut te fresket dhe leshimin per treg duhet te respektojne kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve CE e kombetare qe bejne te mundur vendosjen e normave sanitare qe disiplinojne e kontrollojne prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve te peshkut per qellim human.

Keto struktura perbehen nga:

1. Nje impiant per prodhimin e sasive te nevojshme te akullit per vjelje e paketim.
2. Nje lokal(salle) per paketimin e peshkut te fresket te peshkuar te pajisur me linjen e plote ku futet kalibriatricja automatike dhe te gjithe aksesoret e tjere te prodhuar me material aciaoinox marin.
3. Nje ose me shume salla per per ruajtjen e peshkut te fresket te paketuar.
4. Karrela ngrites,transpalet,pirun etj.
5. Mjet transportues per transportin e peshkut te fresket.
6. Tualetet ,dushet dhe dhomat e zhveshjes per personelin.
7. Nje ambient per mbajtjen e paisjeve dhe materialeve higjeno-sanitare.
8. Nje magazine per mbajtjen e ambalazhit(arkave te polisterolit)
9. Nje dhome e vogel frigoriferike ose ngrirje per mbajtjen e produkteve jo te përshtatshme per konsum human
10. Salla e paketimit te peshkut ka nje porte per hyrjen e produktit dhe porten e fundit per daljen e produktit te paketuar per treg.

Zona e pritjes se peshkut te fresket duhet te jete e ndriçuar mire,me hapesire te mjaftueshme per shkarkimin dhe ngarkimin e materialeve klasifikimin dhe futjen ne dhomat frigoriferike.

Siperfaqet e sheshta duhet te jene prej materialesh qe pastrohen lehtësisht dhe te mundesojne qarkullimin me lehtësi te paisjeve te punes,(pirun,carrela,etj)

Paretet duhet te jene te lemuara(lisho),lehtësisht te pastrueshem dhe rigorozisht hidroizolues.

Portat hyrëse te impiantit duhet te jene te vendosura ne mbështetje perfekte dhe mbyllje tampon duke siguruar vazhdueshmerin e ruajtjes se se zinxhirit te ftohtesise si dhe per te parandaluar kontaminimet dhe infeksionet e jashtme.

Dhomat frigoriferike duhet te jene te taruara ne kufinjte e shkrirjes se akullit, 0-2C°. Brenda dhomes duhet te jete dhe një hapesire e përshtatshme per vendosur një tavoline qe i sherben procesit te inspektimit te produktit nga veterineret e shërbimit veterinar publik.
Ambjentet e pritjes dhe te paktimit te peshkut duhet te kene temperaturen konstante 14 C°.

Garantimi i cilesise se produktit ne respekt te ruajtjes se tij dhe shëndetit te klientit behet duke respektuar te Manualin HACCP te stabilimentit te peshkut te fresket.

1) Te gjitha materialet,paisjet dhe objektet qe jane ne kontakt me produktin duhet:

a. Efektivisht te pastrueshme e nevojshmerisht te dizifektueshme.
b. Pastrimi dhe dizifktimi duhet te kryhen me një frekuence te mjaftueshme per te evituar cdo risk kontaminimi.
c. Pa përjashtim te gjithe kontenitoret dhe cdo lloj ambalazhi duhet te jene prej materialesh qe perballojne demtimet,pastrohen lehte per te eliminuar risqet e kontaminimit.
d. Te jene te instaluara ne menyre te tille qe te lejojne një pastrim adeguat te paisjeve dhe te sipërfaqeve përreth.

2) Kur eshte e nevojshme paisjet duhet te jene te paisura me mekanizmat e nevojshem te kontrollit te nevojshem per te garantuar objektivat rregullores perkatese.
3) Per te ndaluar korrozionin e paisjeve dhe kontenitoreve eshte e nevojshme përdorimi i aditiveve kimike qe duhet bere sipas praktikave korrekte.

Procesi i trajtimit

Procesi i trajtimit, konservimit te peshqve dhe produkteve te detit eshte i thjeshte, ai konsiston ne larjen e ketyre produkteve duke i hequr sasine e papastertive qe keto produkte mbartin nga varkat e peshkimit dhe rrjetat per kapjen e tyre, behet nje seleksionim i peshqve dhe nenprodukteve te detit sipas llojit dhe madhesise se tyre. Me pas kalojne ne procesin e kullimit duke hequr sasin e ujit tee tepert, ku me pas sistemohen ne vasketa sipas llojit dhe madhesise, ku transportohen ne procesin tjeter ate te ngrirjes.

Procesi i ngrirjes

- -Ngrirje ne bllok
- -Ngrirje IQF(tek e tek)

Ngrirja ne bllok realizohet neper forma metalike. Pasi produkti vendoset ne keto forma e fusim ne dhomat frigoriferike ngrirese ku fiken dritat dhe takohet konpresori. Dera e dhomave frogoriferike nuk duhet hapur pa mbaruar ky proces.

Ngrirja IQF konsiston neper rrjeshtimin e produktit nje e nga nje mbi tava inoksi mbi nje shtrese qeseje.Per te ruajtur nje cilesi sa me te mire te produktit ai kalon ne procesin e Glazurimit e cila konsiston ne kalimin e produktit ne nje ene me akull per 2-3 sekonda qe produkti te marre nje shtrese te holle e cila ndihmon ne ruajtjen e cilesise se produktit.

Produktet pasi del nga procesi i ngrirjes kalon ne procesin e paketimit dhe etiketimit. Me pas produkti perfundimtare sistemohet neper paleta dhe ruhet ne dhomat frigoriferike.

Pasi produktet e peshkut jane patruar dhe magazinuar ne temperaturen e kerkuar, ato jane te gatshme per tu tregtuar drejt konsumatoreve, qe jane restorantet dhe lokalet e rajonit te Vlores, si dhe me gjere.

PIANO TERRA

scala 1:100

Plani i Përballimit të Emergjencave

Subjekti "ALMARINA OR" në veprimtarinë e tij, për aktivitetin "Linje Paketimi dhe Magazinim i peshqve", detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin, Inspektoriatin Shteror te Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe autoritetet e Njesise Bashkiake Vendore për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situate emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Te nderhyje ne menyre te menjehershme ne rast te dukurive natyrore apo emergjencave
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

- **Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë**

Objekti eshte ndërtuar me planimetri të rregullt dhe ka respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tijë, duke respektuar me rigorizitet projektin teknik. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të, operimit dhe funksionimit normal të instalimit, të lëvizjes së lirë të punonjësve, magazinimin e lëndës së parë, trajtimin, magazinimin e peshqve, disponon hapësira të mjaftueshëm për parkim, për të përballuar fluksin e ngarkim-shkarkimit të produktit dhe të klientëve, etj, gjithashtu te gjitha ujrat teknologjike te larjes kalojne ne vasken e dekantimit te ndertuar per kete qellim.

- **Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri**

Pozicioni i objekteve/instalimeve përbërëse të Trajtimit, Konservimit dhe Magazinimit te peshqve, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre. Megjithate ne procese te tilla pune, renia e zjarrit ka shum pak gjasa te ndodhe.

- **Rënia nën tension**

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty. E gjithe linja e trajtimit, konservimin, paketimin dhe magazinimit te peshqve eshte e togezuar dhe ne rastet e shkarkesave elektrike nga dukurite natyrore, i gjithe instalimi stakohet ne menyre automatike, qe kontrollohet nga paneli elektrik i funizimit me energji elektrike.

Dhe për këtë rast janë parashikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

- **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë instaluar pajisjet dhe makinerite nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit. Pavaresisht qe terreni ku eshte instaluar magazine e peshqeve eshte ne toke me bazament te qendrueshem, ne procesin e montimit te linjes teknologjike jane marre te gjitha masat e nevojshme qe te behet fiksimi i tyre, duke e rritur qendrueshmerine e linjes teknologjike.

- **Nga përmbytjet**

Objekti dhe sheshi, për ushtrimin e aktivitetit të Linje Paketimi dhe Magazinim i peshqve jane te mbrojtur nga përmbytjet, kjo pare dhe me afersin qe ka objekti me hidrovuorin e Orikumit dhe Impiantin e trajtimit te ujerave te ndotura urbane.

Menaxhimi i prodhimit

Për mbrojtjen e pajisjeve dhe makinerive nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj jane marre keto masa:

- Përreth instalimeve te magazines se peshqve lëvizin vetëm personat e autorizuar.
- Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve te ngurta urbane dhe mbetjeve qe gjenerohen nga procesi i paketimit dhemagazinimit te peshqeve, te cilat jane; lende te aballazheve, letra-kartona, si dhe lende organike te gjeneruara nga pastrimi i peshqeve nga papastertite, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen ne vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku jane vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane te gjeneruara, depozitohen ne kosha brenda territorit te shoqerise ku me pas merren dhe dergohen ne kontenieret e perbashket te mbejteve urbane, nga ku me pas mjetet e pastrimit te bashkise i dergojne ne vendepozitimin e caktuar prej tyre.
- Ne objekt eshte instaluar nje lina e furnizimit me energji elektrike e cila furnizon pajisjet/makinerite me energji elektrike, është i tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qëndrore të shpërndarjes e cila është e siguruar me celësin e sigurisë, për cfardo lloj avarie të mundshme.
- Paisjet e reja jane me te avancuara dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash subjekti ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri/mjete/pajisje gjate punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.

- **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti **"ALMARINA OR"** praktikisht nuk perben rrezik per stafin (punonjesit) e tij, per arsye se investimet jane te koheve te fundit, me nje instalimi/paisje te reja e moderne, i gjithe procesi i punes eshte pothuajse i automatizuar cka e rrit sigurine e zhvillimit te aktivitetit.

Objekti dhe linja teknologjike te Paketimit dhe Magazinimit te peshqve jane nder me bashkohoret dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri gjate punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.

- **Detyrimet e punedhenesit:** Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1- Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.
2- Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne objekt dhe procesin e punes.
3- Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4- Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
5- Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
6- Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne sheshet e punes, per tu mbrojtur nga makinerite/pajisjet, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.

7- Ndihmen e pare shendetesore.
8- Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
9- Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne pune.
10- Para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive/pajisjeve/instalimeve etj.
11- Te informojne punonjesit per termat dhe kushtet e lejes mjedisore

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1- Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2- Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve per çdo proces pune.
3- Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4- Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithe punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik te kantierit te punes.
5- Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, rrobat me çizme pune, doreza,, uniforme te vecanta etj.
6- Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.
7- Te jete i njohur me kushtet e lejes mjedisore

- **Menaxhimi i lëndëve të para**

Sistemi i transportit

Transportimi i lëndëve të para, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në Paketimin dhe Magazinimin e peshqve dhe produkteve te detit sigurohet nga mjetet e subjektit "ALMARINA OR", te cilat jane ne gjendje shum te mire funksionale. Furnizimi me lëndë të pare bëhet periodikisht te siguruara nga varkat e peshkimit dhe peshkataret e rajonit te Vlores dhe nga akuakultura intensive e rritjes se peshkut, por edhe me gjere. Mjetet e transportit dhe makinerite e Paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shmangien e rrezikut për humbje apo demtim të lëndës së pare dhe produkteve gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve është brenda rregulloreve dhe kritereve të transportit.

Dorëzimi i lëndëve të para

Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit. Bëhet verifikimi i materialit që transportohet brenda tyre, nen kujdesin e drejtuesi teknik i operacioneve brenda ne objektin e paketimit dhe magazinimit te peshqve nëse ka mospërputhje sasise se lendes se pare. Pas shkarkimit te lendes se pare (peshqit dhe produktet e detit) mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin normal të punës .

Organizimi i punes dhe fuqia punetore

Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjësve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë, procesi i paketimit dhe magazinimit e peshqve dhe produkteve te tjera te detit është i automatizuar dhe monitorohet nga administratori i shoqerise.

Regjimi i punës do të jetë me 1 turn kur shoqëria do ë punojë me kapacitet të plotë. Punonjësit e punësuar kane eksperiencë shume vjecare në kryerjen e proceseve të ndryshme të paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit.

Per Menaxhimin e materialeve dhe funksionimin e linjes se, paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit ne nje dite te zakonshme pune, skema e funksionimit eshte shume e thjeshte dhe e mire organizuar nga subjekti "ALMARINA OR" ecuria e punes eshte si me poshte:

- Drejtuesit teknik menaxhojne plotësisht të gjithe rrethin e punës ne magazine e peshqve dhe produkteve te detit, duke filluar nga regjistrimi i urdhrave të përditshme, listën e proçesimit të kërkesës, llogaritjen e prodhimit, në përputhje me agregatet që do të përdoret dhe sa ton peshq do te trajtohen dhe magazinohen, sasitë e kërkuara të lëndëve të para, menaxhon kohët e dorezimit dhe shkarkimit, kompenson dhe përmirëson gabimet duke përdorur një sistem vetë-korrigjimi.
  - Kontrollon në kohë reale ecurinë e variablave të punes ne magazine dhe paraqet në grafik visual ne ore.
  - Kontrollon dhe kordinon plotësisht proçeset e punes (dozimin dhe peshat e materialeve të lëngëta dhe ngurta) dhe ofron informacione të vazhdueshme të konsumit.
- Lejon një gamë të gjerë të programeve të punes nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:
  - Menaxhimin e Porosive
  - Skedimin dhe menaxhimin e dokumenteve të shpërndarjes, me një rend automatik të printimit në fund të procesit.
  - Dokumentet menaxhimit të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual.
  - Menaxhimin e lëndës së parë, kur hyjnë dhe dalin
  - Menaxhimin e përditshëm të grumbullimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit.
  - Programet e mirëmbajtjes së makinerive dhe linjes teknologjkike
  - Ruan një skedar të operacioneve ne grumbullimin dhe magazinimin peshqve dhe produkteve te tjera te detit
  - Kontrollon parametrat për shfrytëzimin më të mirë të punes ne magazine e peshqve.
- Drejtuesi Teknik kontrollon rezervat materiale dhe njofton për ato që ka më pak në gjendje.
- Drejtuesi Teknik informon bazën e të dhënave për lëvizjen e materialeve në mënyrë manuale apo automatike.
- Menaxhon kartat mirëmbajtjes së të gjitha automjeteve dhe makinerive, të bazuar në ton/kg apo periudhë kohore
- Drejtuesi Teknik menaxhon pjesën e depozitimit të materialeve dhe rezervave
- Punonjesit
  - Drejtojne operacionet e ngarkim-shkarkimit te lendes se pare
  - Mirembajne, kontrolli dhe riparimi i linjes se instalimit/aparaturave/makinerive/pajisjeve
  - Rakordimi i sasise se materialit te depozituar dhe produktit
  - Magazinimin dhe transportimin e lendeve te para
  - Drejtimin e mjeteve te transportit, ngarkimit dhe shkarkimit
  - Montojne dhe cmontojne detale dhe makinerite e demtuara
  - Drejtojne operacionet per trajtimin dhe magazinimin sa me efikase te lendes se pare dhe trajtimin e tij
  - Menaxhojne procesin e grumbullimit, perpunimit, trajtimit dhe ambalazhimit te produkteve te perftuara.

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon subjekti **"LAMARINA OR"**, në Orikum, Vlore nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për paketimin dhe magazinimin e peshqeve gjenerohet një sasi mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara nga proceset e paketimit dhe magazinimit te peshqve, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje nga industria e trajtimit dhe magazinimit te peshqeve dhe produkteve te detit
- Mbetje të perziera urbane dhe ambalazhit (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, etj)

- **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive ne magazinen e peshqeve. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular per pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij aktiviteti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me aktivitetin e trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit, gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti trajtimit dhe magazinimit te peshqve dhe procesit te larjes se ambienteve te magazines jane ujera me permbajtje yndyre, fosfori dhe nitrati, lende ne pezulli, ujera me permbajtje detergjenti, etj. Keto ujera shkarkohen ne kolektorin kryesor te ujerave te perdorura, me pas kalojne ne vaska dekantuese, e me tej shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones industriale. Nuk ka impiant trajtimi te ujerave te perdorura.

Ne baze te shtojces nr.3 e VKM Nr.177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, vlerat e lejuara per ujerat e shkarkuara nga disa sektore industriale ne mjediset prites ujore:

Sektori industrial	**Parametrat**	**Vlerat e lejuara**
1	**2**	**3**
Trajtim dhe magazinim i peshqve	pH Lendet ne pezulli BOD5 COD Yndyrat Nitrati total Fosfori total	6-9 50 mg/l 50 mg/l 250 mg/l 10 mg/l 10 mg/l 5 mg/l

Emetimet ne ajer

Nga zhvillimi i aktivitetit per trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit te peshqve, nuk kemi shkarkime ne ajer, pervec aromave te cilat eshte e veshtire te behet vleresimi i tyre, pasi dhe vete zona eshte afer lagunes dhe aroma eshte pothuajse e pranishme edhe nese nuk do kishim zhvillimin e ketij aktiviteti.

Zhurmat dhe vibrimet
Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga perdorimi i mjeteve te transportit te magazinimit te lendeve te para te produkteve te peshkut, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, sistemi i aspirimit-kondicionimit. Punëtorët nuk ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin megjithate edhe ne situata te tjera ku niveli eshte me i larte se normat e lejuara ne mjediset e punes, punonjesit mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk shkaktohen vibrime.

Ndikimi ne toke
Proceset e punes per kete lloj aktiviteti nuk ndikojne ne toke, kjo per shkak te shtrimit te shesheve si te brendshme dhe te jashtme me shtresa te pa depertueshme nga uji apo solucione te ndryshme kimike. Ky aktivitet nuk ka ndikuar ne zenien e tokes se re ne asnje faze te tij. Aktiviteti eshte ngritur ne Bashkine Orikum, Vlore. Nuk demtohet bimesia e zones, nuk demtohet relievi as struktura e tokes.

Ndikimi ne Biodiversitet
Kjo zonë bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet. Aktiviteti ndodhet ne nje zone ku nuk ka prekur mjedisin natyror, por gjithesesi, shkarkimi i ujerave te procesit te trajtimit dhe magazinimit pa u trajtuar, shoqerohet me ndikime te rendesishme ne mjedisin/biodiversitetin e burimeve ujore te zones.

Ndikimi ne Mjedisin Social
Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, por jo vetem.

Mbetjet e prodhuara
Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ambalazhet e ushqimeve, Mbetjet urbane nga aktiviteti human, te cilat grumbullohen ne kosha te posacem dhe largohen per ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones (mbetje te parrezikshme, me kodin pa Yll) 20 01 01 “Mbetjet urbane”. Gjithashtu gjenerohen edhe mbetje nga proceset e proceset e paketimit dhe magazinimit te mbetjeve te peshqeve.

INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne mjedis, zgjat per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti i trajtimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit.

SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance fare te ngushte, pra ne nje distance jo me te larget se 100m. Ndersa shkarkimet e ujerave te perdorura pa u trajtuar, i shtrijne efektet e tyre ne disa km ose dhjetera km, kjo si rrjedhoje se nepermjet burimeve ujore te levizshme si perrenjte apo lumenjte, shkarkimet e lengeta te aktivitetit kane vetine te perhapen lehtesisht dhe gjeresisht.

Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit te ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh te karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore.

ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME	
Toka	
Përdorimi i Tokës	- Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni **Dëmtim potencial i vegjetacionit**	- Zbatimi i rregullores së brendshme, - Punime me mbrojtje brënda objektit, lagja e tokës. - Mos cënimi dhe mbrojtja territoreve bujqësore kufitare. - Rrethimi i perimetrit të zonës ku zhvillohet aktiviteti.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të CO2,SO2, NOx, PM, HC	- Mjete me kolaudim optimal. - Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. - Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi efiçent i mjeteve motorrike të transportit. Përdorim cilësor i lendes djegese . - Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. - Evitimi i mbajtjes ndezur të mjeteve të punës në rastet kur në objekt nuk punohet - Pastrimi periodik i ambientit ku mbahet lenda e pare
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	- Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut, vendosja e grilave mbi kanalet e drenazhimit, pastrimi periodik i tyre dhe pusetave qëndrore.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	- Vendosja e kontenierëve brenda dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara. - Transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore. - Vënd grumbullim I diferencuar.
Ujërat e Ndotura Urbane	
	- Vaske dekantimi - Lidhja me rrjetin e brendshem te kanalizimeve - Mirëmbajtja dhe pastrimi periodik i linjës së shkarkimit të ujrave të ndotura teknologjike - Minimizimi i konsumit të ujit. - Maksimizimi i perdorimit te ujit
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	- Përdorimi i mjeteve të kolauduara. - Paisje për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat - Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor **Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve**	- Lëvizshmeria studiuar të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me aktivitetin e Trajtimit, Paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit, i pozicionuar ne Orikum, Vlore nevojitet një monitorim i vazhdueshëm.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të instalimeve.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura teknologjike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt
- Monitorimi I sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale e mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka demtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj.

MONITORIMI DHE REKOMANDIME

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMPUT dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

PLANI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS.

Meqenëse kemi të bëjmë me aktivitetin e trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit te peshqve, shkarkime te ujrave teknologjike, i zhurmës megjithëse ne kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

Nr	***Elementi i Monitorimit***	***Frekuenca***	***Analiza***	***Përgjegjësi***
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga aktiviteti	Periodike	pH, lendet ne pezulli, BOD5, COD, yndyrnat,	Almarina OR
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit	Vazhdueshem	NOx, SOx, CO, CO2, O etj	Almarina OR
4	Monitorim i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.	Vazhdueshëm	Aromat, temperature, pluhurat, Zhurmat dB(A)	Almarina OR
5	Monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	Periodike		Almarina OR

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e

mësipërm eshte bëre konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.
Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.
Monitorimi i cdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlërësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë"
Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis vetëm gjatë fazës së funksionimit dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Per ajrin duhet te monitoroje emetimet e zhurmave ne decibel (dB).
- Per ujin, te monitoroje permbajtjen e lendes ne pezulli, Nevojen Kimike per Oksigjen, Nevojen Biologjike per Oksigjen, yndyrnat, Pehashin, etj
- Per token, duke qene se nuk do te kete shkarkime, nuk aplikohen detyrime

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashte muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra per reduktimin e ndotjes ne mjedis dhe menyren e zbatimit te kushteve te lejes mjedisore.

Regjistimi i të dhënave mjedisore

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrhen të gjitha parametrat e monitoruar nga subjekti **"ALMARINA OR",** mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.